

URDHËR
Nr. 627, datë 26.6.2025

**PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE
KONTROLLIN E SËMUNDJES SË MURTAJËS SË RUMINANTËVE TË VEGJËL**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, të shkronjës “b”, të nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e tregtimit të ruminantëve të vegjël në tregjet e kafshëve të gjalla, panaire dhe grumbullime të tjera.
2. Ndalimi i lëvizjes së ruminantëve të vegjël dhe specieve të tjera të mbarështuara në fermën e prekur nga sëmundja.
3. Intensifikimin e mbikëqyrjes së popullatave të ruminantëve të vegjël.
4. Forcimin e masave të biosigurisë.
5. Kafshët e llojit të imta duhet të mbarështohen sipas kërkesave shëndetësore të mbarështimit të tyre, si dhe të jenë të izoluar nga kafshët e tjera në fermë dhe të kufizohet kontakti me kafshët e tjera.
6. Intensifikimin e fushatave të ndërgjegjësimit të fermerëve, transportuesve të kafshëve, veterinerëve privat dhe shërbimit veterinar shtetëror.
7. Masat e sipërcituara nga pika 1 deri në pikën 6 zbatohen në territorin e:

Nr.	Rrethi	Njësia administrative	Fshati
3 km			
1	Malësi e Madhe	Shkrel	Zagorë
2	Malësi e Madhe	Shkrel	Dedaj
3	Malësi e Madhe	Shkrel	Lohë e Sipërme
10 km			
5	Malësi e Madhe	Shkrel	Bzhetë
6	Malësi e Madhe	Shkrel	Bzhetë Makaj
7	Malësi e Madhe	Shkrel	Qafë Gradë
8	Malësi e Madhe	Shkrel	Reç
9	Malësi e Madhe	Shkrel	Repisht
10	Malësi e Madhe	Shkrel	Vrith
11	Malësi e Madhe	Shkrel	Veç-Kurtaj
12	Malësi e Madhe	Kastrat	Aliaj
13	Malësi e Madhe	Kastrat	Bratosh
14	Malësi e Madhe	Kastrat	Goraj-Budish
15	Malësi e Madhe	Kastrat	Gradec
16	Malësi e Madhe	Kastrat	Ivanaj
17	Malësi e Madhe	Kastrat	Jaran
18	Malësi e Madhe	Kastrat	Kastrat
19	Malësi e Madhe	Kastrat	Pjetroshan
20	Malësi e Madhe	Kastrat	Premal
21	Malësi e Madhe	Kastrat	Vukpalaj
22	Malësi e Madhe	Kastrat	Bajzë
23	Malësi e Madhe	Qendër	Lohë e Poshtme
24	Malësi e Madhe	Qendër	Koplik i Sipërm
25	Malësi e Madhe	Gruemirë	Kokpapaj

8. Intensifikimin e kontrollit veterinar në fermat që mbarështojnë ruminantë të vegjël dhe tregjet e kafshëve të gjalla në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Anila Denaj